



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7042/2025

A.nr. 1669/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1669/2025, të datës 08.09.2025, të parashtruar nga ankuesi A.A nga Mitrovica, kundër organit të punësimit: Komunës së Mitrovicës Veriore, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1669/2025, e datës 08.09.2025, e parashtruar nga ankuesi A.A.

II. Anulohet Vërejtja me shkrim me numër protokolli 09-03007-0013270/25, e datës 14.08.2025, e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Mitrovicës Veriore për ankuesin.

III. Obligohet Udhëheqësit i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës Veriore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke hequr masën disiplinore vërejtje nga dosja personale e ankuesit.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, që të kujdeset për zbatimin e vendimit si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Arsyetim

Nëpunësi civil, A.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 05.09.2025 përmes emailit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 08.09.2025, nën shenjën A.nr.1669/2025, kundër Vërejtjes me shkrim me numër protokolli 09-03007-0013270/25, e datës 14.08.2025, të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.09.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës Veriore, ndërsa kjo e fundit më datë 22.09.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 07.10.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:6643/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.1669/2025 të datës 08.09.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 6002/2025 të datës 08.09.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:6643/2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vërejtjen me shkrim e datës 14.08.2025; Provës shtesë e dërguar nga ankues më datë 08.09.2025; Emailin e datës 14.08.2025 nga ankuesi për V.J; Njoftimin e datës 01.09.2025 nga burimet njerëzore për ankuesin për njoftim të inicimit të procedurës disiplinore; Emailin e datës 13.08.2025, 08.08.2025 nga E prokurimi Helpdesk për M.A; Emailin e datës 13.08.2025, 11.08.2025, 07.08.2025 nga M.A për E prokurimi Helpdesk; Përgjigjen në ankesë e datës 27.08.2025 nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit për ankuesin; Emailin e datës 01.09.2025 nga ankuesin për Drejtorin e Inspektionit; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës i datës 28.02.2025; Emailin e datës 27.08.2025 nga F.B për ankuesin; Provë shtesë e datës 16.09.2025 nga ankuesi; Emailin e datës 16.09.2205 nga ankuesi për L.F, A.S dhe E.S; Emailin e datës 16.09.2025 nga ankuesi për F.B; Emailin e datës 23.09.2025 nga ankuesi për F.B; Emailin e datës 23.09.2025 nga F.B për ankuesin; Emailin e datës 22.09.2205 nga ankuesi për F.B; Vendimin e datës 22.09.2025 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Mitrovicës Veriore për pezullimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.09.2205; Përgjigjen në ankesë e datës 22.09.2025; Akt Emërimit e datës 18.03.2024; Vendimin e datës 11.08.2025 për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave në procesin e tenderit me Nr. Prokurimit 647-25-5386-2-2-1; Emailin e datës 15.09.2025 nga V.S për L.F; Emailin e datës 12.09.2025 nga L.F për V.S; Kërkesën e datës 22.08.2205 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit; Vendimin e datës 11.07.2025; Vendimin e datës 06.03.2025 për anulimin e vendimit të datës 18.09.2024; Vendimin e datës 18.09.2024 për caktimin e ankuesi ushtrues detyre i Udhëheqësi në Sektorin e Inspektionit; Vendimin e datës 27.08.2025 për plotësim ndryshimin e vendimit të datës 16.10.2024; Raportin analitik i përfutjesit data 01.09.2205; Emailin e datës 01.09.2025 nga A.S për V.S; Emailin e datës 01.09,2205 nga V.S për A.S; Vendimin e datës 16.10.2024 për emërimin e menaxherit të kontratës dhe emërimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të

menaxhimit të kontratës; Kërkesë për dëshmi prova materiale në lidhje me procedurën disiplinore datë 08.09.2025 nga Komisionit Disiplinor për Kryetarin e Komunës së Mitrovicës Veriore; Përgjigjen në kërkesë e datës 12.09.2025 për Komisionin Disiplinor nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore; Vendimin e datës 25.10.2024 për autorizim për ankuesin për kryerjen e detyrave nga kompetencat e Inspektorit të Ndërtimit; Procesverbal i inspektimit Nr. 00029 i datës 20.03.2025; Plotësim kërkesë datë 15.09.2025 nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit për Komisionin Disiplinor; Deklaratën e ud. Zyrtares Përgjegjëse të Prokurimit; Vërtetimin me Nr. 517 të datës 25.08.2025; Vendimin e datës 21.08.2024 për caktimin e zyrtarit përgjegjës për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 18.03.2024, mban pozitën e punës *Inspektor i Shërbimeve Publike* në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Tutje sipas shkresave të lëndës, rezulton se sipas Vendimit me numër protokolli 01-030/01-0012962/25 të datës 11.08.2025, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, është formuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave në Procesin e Tenderit “Sigurimit Fizik dhe me Alarm i Objekteve Komunale” në rr.Kollashini si dhe Objekti i QPS-se me Nr. Prokurimit 647-25-5386-2-2-1, në këtë përbërje: 1.1. A.A-kryesues; 1.2. F. S dhe 1.3. D. K anëtarë, mirëpo ankuesi përmes emailit të datës 14.08.2025, drejtuar u.d Zyrtares Përgjegjëse të Prokurimit, ka shprehur shqetësimin e tij për ndërhyrje në pavarësinë e komisionit dhe është tentuar të shtrihet ndikimi të komisionit nga kabineti i Kryetarit respektivisht z. V.S, ku përmes këtij emaili i njëjti ka shprehur se jap dorëheqje nga komisioni përkatës. Si rezultat i këtyre rrethanave, Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Mitrovicës Veriore, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit më datë 14.08.2025 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore Vërejtje me Shkrim me numër protokolli 09-03007-0013270/25, me arsyetimin: *Vërejtja me shkrim për A.A Inspektor i Shërbimeve Publike për mos përmbushje të detyrave të deleguara nga Kryetari i Komunës.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim me numër protokolli 09-03007-0013270/25, e datës 14.08.2025, të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Mitrovicës Veriore, pretendon se vërejtja është tendencioze dhe shantazh kundër tij, dhe këtë e pretendon se janë ndërmarrë edhe një mori veprimesh të tjera ndaj tij sikurse është rasti që largohem nga menaxhimi i kontratës lidhur me mirëmbajtjen e ndriçimit publik, në mënyrë arbitrare kanë hyrë në zyre dhe e kanë ndërruar cilindrin e derës dhe po ashtu jam njoftuar më datë 01.09.2025 nga departamenti i burimeve njerëzore se është iniciuar procedurë disiplinore ndaj meje mbi dyshimin për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi të punës. Kërkon që akti për shqiptimin e masës disiplinore të shpalljet nuk ka këshillë juridike për ankesë.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ndaj masës disiplinore Vërejtjes me shkrim me numër protokolli 09-03007-0013270/25, e datës 14.08.2025, të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Mitrovicës Veriore, ndaj ankuesit, me rastin e vendimmarrjes ju referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenit 56, ku përcaktohet:

“1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: **1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda.** 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”, Nenit 57 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; **1.3. vërejtje me shkrim.** 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil.

Kolegji i Këshillit, fillimisht konstaton se sipas Vendimit me numër protokolli 01-030/01-0012962/25 të datës 11.08.2025, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, është formuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave në Procesin e Tenderit “Sigurimit Fizik dhe me Alarm i Objekteve Komunale” në rr. Kollashini si dhe Objekti i QPS-se me Nr. Prokurimit 647-25-5386-2-2-1, e në të cilin komision ankuesi është caktuar si kryesues, mirëpo nëse i referohemi provave të lëndës, ankuesi shqetësimet e tij lidhur me pretendimet për ndërhyrje në pavarësinë e komisionit dhe që është tentuar të shtrihet ndikim te komisioni nga kabineti i Kryetarit respektivisht z. V.S, nuk i ka shfaqur tek personi i cili e ka nxjerr vendimin e cekur si më lartë, por të njëjtat i ka shfaqur përmes emailit të datës 14.08.2025 tek u.d Zyrtares Përgjegjëse të Prokurimit të Komunës së Mitrovicës Veriore duke shprehur përmes këtij emaili se jap dorëheqje nga ky komision e për

rrjedhë si rezultat i këtyre veprimeve respektivisht *për mos përmbushje të detyrave të deleguara nga Kryetari i Komunës*, ndaj ankuesit është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me shkrim e datës 14.08.2025.

Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret do të shqyrtohet ligjshmëria e aktit të kundërshtuar respektivisht do të shqyrtohet masa disiplinore Vërejtje me shkrim me numër protokolli 09-03007-0013270/25, e datës 14.08.2025, e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Mitrovicës Veriore ndaj ankuesit, dhe nëse i referohemi kuadrit ligjor të cekur si më lartë , vijmë në përfundimin se masa disiplinore ndaj ankuesit Vërejtje me shkrim e datës 14.08.2025, është masë e lehtë e parashikuar me nenin 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L1-97 për Zyrtarët Publikë dhe e njëjta shqiptohet vetëm për shkeljet e kryera sipas nenit 56 paragrafi 3 të këtij ligji, e që në rastin konkret nëse shihet përmbajtja e vërejtjes ,e njëjta është shqiptuar për mos përmbushje të detyrave, që fillimisht duhet potencuar që shkelja e tillë nuk hyn në kuadër të shkeljeve të lehta disiplinore, ndërsa çështja kryesore e që përbën elemente qenësore për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar nga ankuesi, rezulton se akti i kundërshtuar apo vërejtja me shkrim e datës 14.08.2025, nuk ka fare ndonjë arsyetim të gjendjes së fakteve dhe nuk ka asnjë përshkrim se sipas cilave dispozita ligjore ankuesi ka kryer shkeljet e supozuara, e nëse i referohemi dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në këtë rast që e ka shqiptuar masën disiplinore ndaj ankuesit, ka qenë i obliguar që fillimisht të kualifikoj shkeljen e supozuar nga ana e ankuesit se veprimet e ankuesit a përbëjnë shkelje të lehta apo të rënda disiplinore dhe tek më pas si rezultat i një kualifikimi të tillë të ndërmarrë veprimet juridike të përcaktuar ligjërisht.

Kolegji i Këshillit, konstaton se për t'u konsideruar kjo masë disiplinore si e ligjshme, duhet të përmbajë elementet e kualifikimit të shkeljes së supozuar nga ana e ankuesit, konstatimin apo shpjegimin e drejtë të gjendjes faktike, përmbajtjen e normave referencave ligjore me të cilat do të përcaktojë se cilat nga veprimet e supozuara nga ana e ankuesit bien ndesh me njërën apo me dispozitën tjetër ligjore, e që në rastin e shqiptimit të masës disiplinore vërejtje me shkrim të datës 14.08.2025 ndaj ankuesit nuk janë aplikuar, e për rrjedhë Kolegji i Këshillit, vlerëson se në rastet kur një akt nuk përmban gjendjen e fakteve dhe përcaktimin e normave ligjore siç parashihet me dispozitat e nenit 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë edhe vetë akti konsiderohet që nuk është i ligjshëm respektivisht plotëson elementet e paligjshmërisë së përcaktuar me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara. Andaj duke marr parasysh konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit, meqë konstaton paligjshmërinë e vërejtjes me shkrim të datës 14.08.2025, nuk ka mundur të shqyrtoj nëse veprimet e ankuesit përbëjnë elemente të përgjegjësisë disiplinore, ndërsa sipas shkresave të lëndës, shihet që ndaj palës ankuese është iniciuar edhe procedurë disiplinore më datë 22.08.2025 e ku ndër pikat është edhe mos përmbushja e detyrave të deleguara nga kryetari i komunës, mirëpo në këtë rast pas përfundimit të procedurës disiplinore pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë sipas afateve të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, pas vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi dhe konstatimeve si në arsyetim të këtij vendimit, vendosi të aprovoj ankesën e ankuesit për shkak të shkeljeve procedurale me rastin e shqiptimit të masës disiplinore vërejtje me shkrim të datës 14.08.2025, vendosi që si rezultat i

këtyre shkeljeve të anulojë të njëjtën dhe po ashtu obligoj Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës Veriore që sipas dispozitivit dhe arsytimit të këtij vendimi të ndërmerr të gjitha veprimet që masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit të largohet nga dosja personale.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1669/2025, datë 29/10/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.A;
- Organit të punësimit: Kryetarit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës Veriore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.